REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE
EMERGJENCA CIVILE

Nr.491 Prot.

Krumë.më.22 / 04.2026

PLAN- MASASH

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË HAS
MIFTAR DAUTI

PËR
PËRGATITJEN, PARANDALIMIN, MBROJTJEN DHE PËRGJIGJJEN NDAJ SITUATAVE TË MUNDSHME TË ZJARREVE TË KRIJUARA SI PASOJË E TEMPERATURAVE TË LARTA

2026

Adresa: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al

I. BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore".
- Ligji nr. 45, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".
- Ligji nr. 152, datë 21.12.2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"
- Ligjit nr.57, datë 30.04.2020 "Për pyjet"
- VKM nr. 923, datë 25.11.2020 "Për funksionimin e organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile".
- Planit të Mbrojtjes Civile të Bashkisë Has.

II. PARANDALIMI DHE PËRGJIGJIA NDAJ SITUATAVE EMERGJENTE QË MUND TË KRIJOHEN NGA ZJARRET

1. PARANDALIMI I SITUATAVE EMERGJENTE QË MUND TË KRIJOHEN NGA ZJARRET

OBJEKTIVA DETYRAT VEPRIMET/MASAT PËR T`U NDËRMARRË AFATET DHE INSTITUCIONI PËRGJEGJËS				
NR	**OBJEKTIVI / DETYRA**	**VEPRIMET / MASAT PËR T`U NDËRMARRË**	**AFATI**	**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS**
1	Shmangia e situatave të emergjencave civile, si dhe zvogëlimi i prekshmërisë sociale, ekonomike dhe mjedisore që mund të shkaktohen nga zjarret.	• Informacion të ndërsjellë midis strukturave qendrore dhe vendore të planifikimit, monitorimit, vlerësimit në lidhje me situatat e zjarreve. • Monitorimi në mënyrë të vazhdueshme i territorit për dukurinë e shfaqjes së zjarreve. • Gadishmëria e automjeteve dhe pajisjeve zjarrfikëse. • Raportimi në QKO të Emergjencave Civile/Agjensinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për çdo situatë të zjarreve që ndodh në territorin e Bashkisë.	Gjatë gjithë kohës.	Kryetari i Bashkisë Sektorët Përgjegjës. Njesitë Administrative të Rrethit te Hasit
2	Zbatimi i detyrave të parashikuara në Ligjin nr 45, datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile" në Planin e Mbrojtjes Civile të Bashkisë dhe aktet e tjera nënligjore për emergjencat civile.	Funksionimi i Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile në nivel vendor dhe i strukturave të mbrojtjes civile.	Gjatë gjithë kohës.	Kryetari i Bashkisë Njesitë Administrative të Rrethit te Hasit

3	Përcaktimi i roleve dhe i përgjegjësive të qarta të strukturave për parandalimin e situatave të emergjencave civile që mund të krijohen nga zjarret.	Analiza e gjendjes së mbrojtjes civile, nga çdo Njesi Administrative, institucion vendor sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore që ka lidhje me problematikat që mund të vijnë si pasojë e zjarrëve.	Qershor Korrik	Kryetari i Bashkisë. Njesitë Adm. të Rrethit te Hasit.
4	Plane për përballimin e emergjencave civile që mund të krijohen nga zjarret.	• Përditësimi i planeve të gatishmërisë nga Njesite Administrative, strukturat në varësi të tyre,Sektorët Përgjegjës për planifikimin dhe përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga zjarret. • Përditësimi i planeve të gatishmërisë sidomos nga Njesitë Administrative në territorin e të cilave ka zona turistike, me qëllim parandalimin,monitorimin dhe ndërhyrjen për shuarjen e zjarreve dhe garantimin e turizmit për pushuesit.	Qershor	Kryetari i Bashkisë Sektorët Përgjegjës. Njesitë Administrative të Rrethit të Hasit
5	Sigurimi i shërbimit shëndetësor për zonat që mund të preken nga zjarret.	Sigurimi i gatishmërisë së autoambulancave të shërbimit për Njesite Administrative që preken nga zjarret.	Gjatë gjithë periudhës verore.	Njësitë Vendore të Shendetit Publik. Drejtoritë Spitalore
6	Kontrolli i realizimit të tërësisë së masave parandaluese.	Inspektim të strukturave përgjegjëse në Njesi Administrative e Sektorët Përgjegjës që veprojnë në nivel vendor, për marrjen e masave parandaluese në përballimin e zjarrëve.	Qershor-Korrik	Kryetari i Bashkisë
7	Sigurimi i fondeve të nevojshme për situatat e mundshme të emergjencave që mund të krijohen nga zjarret.	Sigurimi i fondeve financiare për alokimin e tyre në kohë, për ndërhyrjen e forcave dhe mjeteve në operacionet emergjente të nevojshme për shkak të situatave që mund të krijohen nga zjarret.	Sipas rastit, gjatë gjithë periudhës.	Njesitë Administrative të Rrethit të Hasit Sektorët Përgjegjës
8	Informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut.	• Sensibilizimi i opinionit publik me të gjitha format, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi i tyre për rrezikun që vjen si pasojë e temperaturave të larta, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të tyre, si dhe kujdesin që duhet të tregojnë në veprimtarinë e tyre për mos shkaktimin e zjarreve. • Bashkëpunimi me mediat lokale me qëllim sensibilizimin e komunitetit. • Realizimi i funksionimit të sistemit të monitorimit, paralajmërimit të hershëm,njoftimit dhe alarmit.	Gjatë gjithë periudhës përgatitore.	Kryetari i Bashkisë Njesitë Administrative të Rrethit të Hasit Sektorët Përgjegjës.

2. PËRGJEGJËSIA NDAJ SITUATAVE EMERGJENTE QË MUND TË KRIJOHEN NGA ZJARRET

OBJEKTIVA DETYRAT VEPRIMET/MASAT PËR T`U NDËRMARRË AFATET DHE INSTITUCIONI PËRGJEGJËS				
NR	**OBJEKTIVI / DETYRA**	**VEPRIMET / MASAT PËR T`U NDËRMARRË**	**AFATI**	**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS**
1	Sigurimi i jetës së njerëzve	Rritja e gatishmërisë, lajmërimi i shpejtë, sipas rastit, i popullatës dhe dhënia e informacionit të ndërsjelltë, për shkak të situatës së zjarreve.	Sipas situatave.	Kryetari i Bashkisë Njesitë Administrative të Rrethit te Hasit Sektorët Përgjegjës.
2	Evakuimi	Evakuimi i popullsisë në rast nevoje, me qëllim mbrojtjen e jetës, gjësë së gjallë dhe pasurisë së tyre nga zjarri.	Sipas situatave.	Forcat operacionale: MZSH,Policia Vendore,DMR Nj.Administrative.
3	Ruajtja e shëndetit të popullsisë.	• Sigurimi i shërbimit të ambulancës dhe të emergjencës mjekësore, për zonën e prekur nga zjarri. • Informimi për aktivizimin e shërbimit të njësisë së helikopterëve për emergjencën mjekësore në rast nevoje.	Gjatë gjithë periudhës.	Njësia Vendore e Kujdesit Shendëtësor. Sherbimi Nj.V.K.Sh. Has(Spitali).
4	Ruajtja e rendit dhe sigurisë	Marrja e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në zonat e prekura nga zjarri.	Sipas situatave.	Komisariati i Policisë.
5	Reagimi ndaj situatave të krijuara nga zjarret.	• Komunikimi me Shërbimin Meteorollogjik, strukturat monitoruese për marrjen e informacionit të vazhdueshëm për parashikimin e motit dhe rreziqeve natyrore. • Marrja e informacionit periodik dhe rast pas rasti, rreth situatës së zjarreve në territorin e vendit.	Gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të situatave.	Kryetari i Bashkisë Njesitë Administrative të Rrethit të Hasit Kryetari i Bashkisë Njesitë

		• Kordinimi, sipas shkallës së fatkeqësisë, i mjeteve ajrore, mjeteve tokësore dhe forcave operuese për të ndërhyrë në kohë, në përballimin e situatës së krijuar nga zjarret. • Bashkërendimi i veprimeve me Ministritë e linjës, Kryetarin e Bashkisë,e të gjithë aktorët , për menaxhimin e situatës dhe dhënien e asistencës së nevojshme lidhur me koordinimin e veprimeve. • Marrja e masave për pritjen e përcjelljen e ekipeve të huaja, të ndihmës humanitare, zbatimi i proçedurave të mbështetjes së vendit pritës.		Administrative të Rrethit të Hasit Prefektit të Qarkut, KMC-se Qarkut, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Kryetari i Bashkisë Njesitë Administrative të Rrethit të Hasit Ministrinë e linjës. Kryetari i Bashkisë Nj. Adm të Rrethit të Hasit Deget Territoriale Kryetari i Bashkisë, AKMC-ja Dogana, Nj. Adm të Rrethit të Hasit
		• Marrja e masave të kontrollit dhe të disiplinimit të qarkullimit rrugor, me qëllim krijimin e lehtësirave për qarkullimin e forcave operacionale dhe popullsisë.	Gjatë gjithë periudhës	Komisariati i Policise
		Vënja në dispozicion të operacioneve të ndërhyrjes të burimeve njerëzore dhe logjistike.	Gjatë gjithë periudhës	Kryetari i Bashkisë Njesite Administrative te Rrethit te Hasit Sektorët Përgjegjës.
		Në varësi të situatës, sigurimi i furnizimit me energji elektrike për zonat e prekura nga zjarri, në bashkëpunim me OST dhe	Gjatë gjithë periudhës	OSHEE-ja.

		OSHE.		
		Sipas rastit, vënja në dispozicion të emergjencës së shkaktuar nga zjarret, të shkollave, konvikteve, qendrave sportive etj., në rast evakuimi të popullsisë.	Gjatë gjithë periudhës	Njesite Administrative te Rrethit te Hasit Sektorët Përgjegjës.
		• Kërkimi i ndihmës në nivel qendror, kur situatat e krijuara nga zjarret janë përtej mundësive apo kapaciteteve të Njesive Administrative dhe Bashkisë. • Mbajtja e kontakteve të vazhdueshme dhe bashkërendimi i veprimeve me Ministrinë e Mbrojtjes me (AKMC-në), në rast se shpallet gjendje e fatkeqësisë natyrore, si dhe me QKOEC-në, në varësi të situatës dhe me Kryeministrin. • Ndjekja në kohë e situatës së informacionit në fazën fillestare të konstatimit të vatrës së zjarrit, si dhe angazhimin e menjëhershëm të të gjitha kapaciteteve njerëzore dhe teknike. • Sensibilizimin e të gjitha strukturave, institucioneve, shoqërisë civile në juridiksionin e Bashkisë. • Bashkërendimi i veprimtarive institucionale të nevojshme në të gjitha etapat e përgjigjes ndaj situatës së krijuar nga zjarret. • Bashkëpunimi në mënyrë të veçantë me strukturat e Komisariatit te Policise Dega Has, duke identifikuar dhe duke vënë para përgjegjësisë të gjithë zjarrëvënësit, qofshin ato me dashje apo nga pakujdesia, ndjekjen deri në fund të çështjeve që lidhen me zjarrvënësit, si dhe publikimin apo informimin e publikut apo informimin e publikut mbi autorët. • Vlerësimi i nevojave materiale dhe financiare, dëmeve të shkaktuara, dhe i kërkesave për asistencë nga ana e strukturave të tjera qendrore në nivel Bashkie. • Në bashkëpunim me Njesitë Administrative, bashkërendimi i forcave operacionale të përfshira në operacione, ekipe të ndihmës, vullnetarëve të cilët veprojnë në Bashki. • Bashkërendimi i punës me kryetarët e njësive administrative për përgjigjen ndaj situatës, si dhe informimi	Gjatë gjithë periudhës	Kryetari i Bashkisë Njesitë Administrative të Rrethit të Hasit Sektorët Përgjegjës.

		në mënyrë periodike i MM-së për nevojat dhe kërkesat e ndryshme. • Hartimi i rraporteve periodike për situatën dhe dërgimi në mënyrë të vazhdueshme në QKOEC-së. • Kordinimi i punës me Sektorët Përgjegjës dhe ministritë e linjës në mënyrë që të aktivizohen të gjitha burimet e nevojshme njerëzore material dhe teknike për përballimin e emergjencës.		
		Bashkëpunimi me administratën e Kryetarit te Bashkisë, Komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Mbrojtjes Civile në Bashki.	Gjatë gjithë periudhës.	Këshilli Bashkiak.
		Organizimi i: -Paralajmërimit të hershëm, njoftimit dhe alarmit, si dhe informimit të strukturave dhe popullsisë në rrezik: -Evakuimit dhe strehimit të popullsisë; -Skuadrave, grupeve dhe strukturave të tjera aktive të përgatitura për të parandaluar, për të lehtësuar dhe për tju përgjigjur në rastet e zjarreve. • Bashkëpunimi i ndërsjelltë i strukturave të Nj.Admin, inspektoriateve përkatëse me strukturat e policisë së Shtetit duke identifikuar dhe duke vënë para përgjegjësisë të gjithë zjarrvënësit, qofshin ato me dashje apo nga pakujdesia, ndjekjen deri në fund të çështjeve që lidhen me zjarrvënësit,si dhe informimin e publikut mbi autorët. • Angazhimin e strukturës së shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe shpëtimit në operacionet për fikjen e zjarreve. • Angazhimi i strukturave të tjera të Nj.Adm. dhe të vullnetarëve në mbështetje të forcave operacionale të angazhuara për fikjen e zjarreve. • Hartimi i rraporteve të situatës me shkrim për Kryetarin e Bashkisë, dhe në rast se kërkohet dërgimi i tyre direkt dhe në QKOEC. • Shpërndarja e asistencës së ardhur për familjet me banesa të dëmtuara nga zjarri.	Gjatë gjithë periudhës.	Njësitë Administrative në Rrethin Has.

7.	Alokimi i fondeve rezervë për situatat e krijuara, në rastet e emergjencave të shkallës së lartë të shkaktuara nga zjarret.	• Hapja e një numri llogarie për donacionet financiare nga subjektet fizike dhe juridike, vendase dhe të huaja. • Alokimi i fondeve të nevojshme për menaxhimin e situatës së shkaktuar nga zjarret.	Sipas situatës emergjente.	Njësitë Administrative në Rrethin Has.
8.	Informimi i publik.	Në rast emergjencash civile të shkaktuara nga zjarret, sigurimi i informacionit nga strukturat qendrore dhe vendore, në lidhje me situatën e krijuar nga zjarret si dhe informimi i popullsisë së rrezikuar dhe i publikut.	Gjatë gjithë periudhës.	Kryetari i Bashkisë Njësitë e vetqeverisjes vendore. Sektorët Përgjegjës
9.	Në rast emergjente që mund të ndodhin si pasoje e rënies së zjarrit (në banesa).	Masat që do merren: 1-Qadër. 2-Ushqime. 3-Detergjente. 4-Veshmbathje; dyshekë, jastek, krevata, batanije, qarqafe, dhe rroba për peërdorim vetjak. 5-Enë guzhine; stufë gatimi, lugë, pirunjë, pjata, tepsia. 6- Frigorifer,televizor. 7. Gjenerator.	Deri në stabilizimin e familjes, për strehim të përkohshëm.	Kryetari i Bashkisë. Sektori i Emergjencave Civile.

3. PROBLEMATIKA

- Mjetet zjarrfikëse në dispozicion të strukturave të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, përgjithësisht janë të vjetra dhe të amortizuara.
- Mungesë në pajisjet zjarrfikëse dhe në uniforma zjarrfikëse.
- Mungesa e infrastrukturës rrugore në zonat pyjore.

Përgjegjësi i Emergjencave Civile

FATOS AHMATI

Drejtoresha e Mbrojtjes Civile

ARBËRIE RADA

***Adresa**: Sheshi "Deshmoret e Hasit", Pallati i Kultures "Pjeter Bogdani", Qyteti Krumë, Rrethi Has,*
Tel/Fax.: +355 214 22080, E-mail: info@bashkiahas.gov.al